

KËRKESË
Nr.6464/1, datë 25.10.2011
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë: bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi dhe shfrytëzimi i linjës tregtare, me rrymë të vazhduar, të interkonjeksionit, Shqipëri-Itali”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është shoqëria “Interconnector Albania” sh.p.k., Tiranë. Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkohmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për secilin pronar sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço